



www.legjislaioni.gov.al

# Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 5

Tiranë – E hënë, 8 qershor 2015

## PËRMBAJTJA

|                                                                                       |                                                                                                                                                    |   |
|---------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---|
| Vendim i Gjykatë së Rrethit<br>Gjyqësor Tiranë<br>nr. 11369, datë 13.11.2013          | Me objekt çeljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë<br>“Italkrom Albania” sh.p.k.....                                                      | 3 |
| Kërkesë e Ministrisë së Financave<br>nr. 5995, datë 3.6.2015                          | Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme,<br>pronë private, që preken nga zgjerimi i rrugës hyrëse të doganës<br>Morinë..... | 4 |
| Njoftim i ministrit të Bujqësisë,<br>Zhvillimit Rural dhe<br>Administrimit të Ujërave | Për vend të lirë pune.....                                                                                                                         | 5 |

**VENDIM****Nr. 11369, datë 13.11.2013****NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, e përbërë nga:

**GJYQTAR:** Arben Kostandini

Asistuar nga sekretare gjyqësore Merita Lila, sot më datë 13.11.2013 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike çështjen civile, që i përket palëve:

**KËRKUES:** Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj, përfaqësuar në gjykim me autorizim nr. 22251 prot., datë 6.12.2011 nga Alketa Dumani.

**OBJEKTI:** Çelja e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Italkrom Albania” sh.p.k.

**PERSON I TRETË:** Shoqëria “Italkrom Albania” sh.p.k., me seli: rruga “Andon Zako Çajupi”, nr. 1 (në mungesë).

**BAZA LIGJORE:** Neni 104, pika “ç”, e ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, ligji nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, i ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008.

Gjykata, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, administroi provat dhe pretendimet e fundit të përfaqësueses të kërkuarit, e cila kërkoj pranimin e kërkesës,

**VËREN:**

Me kërkesën në gjykim, pala kërkuuese kërkon që në rrugë gjyqësore të vendoset çelja e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Italkrom Albania” sh.p.k. Kërkesa në gjykim mbështetet në nenin 104, pika “ç” të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në RSH”, ligjin nr. 8901, datë 23.5.2002, “Për falimentimin”, të ndryshuar me ligjin nr. 9919, datë 19.5.2008.

Me vendimin nr. 203, datë 19.1.2012, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur:

*Kthimin pa veprim palës kërkuuese të kërkesës dhe akteve të saj.*

Kundër këtij vendimi është bërë ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë, e cila, me vendimin nr. 254, datë 10.4.2012, ka vendosur:

- Prishjen e vendimit nr. 203, datë 19.1.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe kthimin e çështjes për rigjykim në atë gjykatë me tjetër trup gjykues.

Nga hetimi gjyqësor rezultoi se:

Shoqëria “Italkrom Albania” sh.p.k., e regjistruar si shoqëri nën administrimin e Drejtorisë Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj me NIPT 72305024 J, me administrator z. Mario Appollonia, ushtron aktivitet në kërkim, eksplorim, shfrytëzim mineraleve. Sipas të dhënave që disponohen nga organi tatimor, kjo shoqëri rezultoi të mos ketë deklaruar veprimtari tregtare për një periudhë për të paktën 2 vjet nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2006, duke e plotësuar kështu kushtin I, të nenit 104, pika 1, germa “ç” të tij.

Në bazë të nenit 104 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, kërkon në gjykatë fillimin e procedurës së falimentimit për tatimpaguesit shoqëri tregtare dhe sipas nenit 4 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, të ndryshuar, kërkoj çeljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë “Italkrom Albania” sh.p.k.

Gjykata, pasi shqyrtoi materialet e çështjes civile të paraqitura në bazë të nenit 3 dhe 4 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, të ndryshuar, çmoi se Gjykata është kompetente nga pikëpamja e kompetencës lëndore dhe tokësore për shqyrtimin e çështjes.

Në bazë të nenit 35 të Kodit të Procedurës Civile dhe nenit 3 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, të ndryshuar, gjykimi u zhvillua me një gjyqtar të vetëm.

Gjykata, në përputhje me nenin 18 paragrafi 1/a të ligjit, i cili parashikon se gjatë shqyrtimit të kërkesës për hapjen e procedurës së falimentimit, si dhe me nenin 222/a të Kodit të Procedurës Civile, ku përcaktohet se, “Kur, për konstatimin ose qartësimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim kërkojnë njohuri të posaçme në fushat e shkencës, teknikës ose të artit, gjykata mund të thërrasë një ose më shumë ekspertë”, me vendimin e ndërmjetëm nr. 3754 akti, datë 13.3.2013, vendosi të emërojë si administratore të përkohshme të falimentimit znj. Mimoza Cara (Memoci), edhe për të kryer detyrat që përcakton neni 18 i ligjit.

Në përmbushje të detyrës së caktuar nga Gjykata, administratorja e përkohshme, znj. Esmeralda Balluku, përpiloi raportin për vlerësimin e gjendjes ekonomike financiare dhe gjendjes së aftësisë paguese të shoqërisë “Italkrom Albania” sh.p.k.



Në bazë të raportit të vlerësimit të administratores së përkohshme të falimentit, arin në konkluzion se:

- Mungon dokumentacioni i nevojshëm për t'u shprehur.

- Nëse ekziston shkaku real për hapjen e procedurës së falimentimit të shoqërisë "Italkrom Albania" sh.p.k.

- Se pasuritë e nevojshme mbulojnë shpenzimet e procedurës së falimentimit dhe të shpenzimeve paraprahe të cilat do të jenë të nevojshme për t'u kryer.

- Nëse është e nevojshme, të merren masat e sigurimit për aktivet e shoqërisë.

- Nëse shoqëria "Italkrom Albania" sh.p.k. ka mundësi reale për zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë ekonomike dhe aktivitetit të saj.

Sa më sipër, duke qene se administratorja e përkohshme e falimentit, me provat e paraqitura nga kërkuesi, nuk arrin të konkludojë për faktin se duhet kaluar kjo shoqëri në falimentim apo jo, gjykata çmon se kërkesa e kërkuesit është e pambështetur në prova e, si e tillë, ajo duhet rrëzuar.

#### PËR KËTO ARSYE,

Në bazë të nenit 306 e vijues të Kodit të Procedurës Civile dhe të neneve 51 e në vazhdim, si dhe 163, të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 "Për falimentimin", të ndryshuar,

#### VENDOSI:

Rrëzimin e kërkesës si e pambështetur në prova e në ligj.

Shpenzimet gjyqësore siç janë bërë.

Kundër vendimit lejohet ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë brenda 15 ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e shpalljes së vendimit.

U shpall sot në Tiranë, më 13.11.2013

SEKRETARE  
Merita Hila

GJYQTARI  
Arben Kostandini

Shënim.

Për vendimin civil me nr. 11369, datë 13.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, që i përket:

PADITËS: Drejtoria Rajonale Tatimore e Tatimpaguesve të Mëdhenj.

Kundër këtij vendimi është bërë ankim dhe aktet i janë dërguar Gjykatës së Apelit Tiranë e cila me vendimin nr. 75, datë 10.2.2015 ka vendosur:

Ndryshimin e vendimit nr. 11369, datë 13.11.2013 të Gjykatës së Rrethit Tiranë dhe pranimin e kërkesës për çeljen e procedurës së falimentimit për shoqërinë "Italkrom Albania" sh.p.k.

Kundër këtij vendimi lejohet rekurs sipas ligjit në Gjykatën e Lartë.

Tiranë më 6.5.2015

SEKRETARE  
Mimoza Cenaj-Lulaj

KANCELAR  
Edmond Ademi

#### KËRKESË

Nr. 5995/9, datë 3.6.2015

#### PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Financave shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga zgjerimi i rrugës hyrëse të doganës Morinë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

Me anë të kësaj shpallje, bazuar në raportin e vlerësimit përfundimtar të komisionit të posaçëm të shpronësimit, ngritur me urdhrin nr. 31, datë 22.4.2015, kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim.

Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore sipas tabelës bashkëlidhur shpalljes, brenda 15 ditëve nga plotësimi i afatit të publikimit, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Financave).

Ky publikim bëhet për llojin e pasurisë: arë, truall, tokë bujqësore.

Vlera totale e shpronësimit është 285 436 lekë.

Pronarët, për të cilët në kolonën shënime në tabelën e publikuar është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP", do të kompensohen për efekt shpronësimi pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe paraqitjes së dokumentacionit respektiv të pronësisë.

ZËVENDËSMINISTRI I FINANCIVE  
Irena Beqiraj



LISTA E PRONARËVE PRIVATË QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË  
ZGJERIMIT TË RRUGËS HYRËSE NË DOGANËN MORINË, KUKËS

| Fshati | Nr | Pronari                                                                                                                                                                                                                                                                                             | Zona kadastrale | Nr. i pasurisë   | Lloji i pasurisë          | Sip. m <sup>2</sup> | Çmimi lekë/m <sup>2</sup> | Vlera totale lekë | Lloji i vërtetimit   |
|--------|----|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------|------------------|---------------------------|---------------------|---------------------------|-------------------|----------------------|
|        |    |                                                                                                                                                                                                                                                                                                     |                 |                  |                           |                     |                           |                   | Konfirmuar nga ZVRPP |
| Morinë | 1  | Rive Iljaz Duraku                                                                                                                                                                                                                                                                                   | 2724            | 91/15            | Arë                       | 208                 | 114                       | 23,712            | Konfirmuar nga ZVRPP |
|        | 2  | Xhevahire Qazim Gjuta (Duraku) (B/50%), Hazir Qazim Duraku (B/50%)                                                                                                                                                                                                                                  | 2724            | 92/3<br>(92/3/1) | Truall                    | 459                 | 202                       | 92,718            | Konfirmuar nga ZVRPP |
|        | 3  | Seladin Ymer Duraku, Lavdi Ymer Duraku, Sanije Ymer Gjuta, Elmije Ymer Ahmetaj, Shkurte Imer Dogjani, Zelihe Ymer Kadena, Myrvete Ymer Sinani, Ilir Hysni Duraku, Shkumbin Hysni Duraku, Arjana Hysni Peposhi, Laureta Hysni Asllanaj (Duraku), Fidaije Hysni Brahimi (Duraku), Gazmir Hysni Duraku | 2724            | 92/4<br>(92/4/1) | Truall                    | 787                 | 202                       | 158,974           | Konfirmuar nga ZVRPP |
|        | 4  | Lavdi Imer Duraku                                                                                                                                                                                                                                                                                   | 2724            | 238/12           | Pemëtore (tokë bujqësore) | 88                  | 114                       | 10,032            | Konfirmuar nga ZVRPP |
|        |    | <b>Shuma</b>                                                                                                                                                                                                                                                                                        |                 |                  |                           | <b>1,542</b>        | <b>167</b>                | <b>285,436</b>    |                      |

### NJOFTIM

Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, në kuadër të zbatimit të programit PROMAS (Programi për Modernizimin në Sektorin e Bujqësisë), shpall pozicionin e lirë të punës për specialist prokurimi.

Të dhëna më të detajuara për përshkrimin e pozicionit të punës dhe kërkesave për kandidatët do t'i gjeni në faqen zyrtare të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave [www.bujqesia.gov.al](http://www.bujqesia.gov.al) si dhe [utl.albania@esteri.it](mailto:utl.albania@esteri.it).

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.  
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.